

URDHËR
Nr. 122, datë 16.2.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 536, DATË 27.9.2019,
“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË NGJALËS EVROPIANE
(*ANGUILLA ANGUILLA*) NË SHQIPËRI, PËR PERIUDHËN 2019–2025”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në “Planin e menaxhimit të ngjalës (*Anguilla Anguilla*)”, bashkëlidhur urdhrit nr. 536/2019, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në nënndarjen “Masat menaxhuese”, pas paragrafit të parë shtohen:

- “Ndalohet zënia e ngjalës qelqore me synim tregtimin e saj. Lejohet vetëm grumbullimi i ngjalës qelqore për arsye riprodhimi;

- Ndalohet zënia e ngjalës në të gjitha stadet e zhvillimit (qelqore, e verdhë/jeshile dhe e argjendtë) nga peshkimi çlodhës-argëtues;

- Zënia e ngjalës kryhet vetëm nga subjektet e autorizuar”.

b) Seksioni II “Sasitë e ngjalës së argjendtë që lëshohen (faza e të rriturve që ndërmerr migrimin riprodhues) në det”, shfuqizohet.

c) Në seksionin III “Kufizimet në lidhje me mjetet e peshkimit” bëhen këto ndryshime:

i. Pas pikës I shtohet pika I/I me këto përmbajtje:

“I/I. Ndalohet zënia e ngjalës në të gjitha stadet e zhvillimit (qelqore, e verdhë/jeshile dhe e argjendtë):

- Laguna e Vilunit në periudhën 15 mars – 30 shtator;

- Laguna e Vainit në periudhën 10 mars – 31 gusht;

- Laguna e Kunesë në periudhën 10 mars – 31 gusht;

- Laguna e Patokut në periudhën 15 mars – 30 shtator;

- Laguna e Karavastasë në periudhën 5 mars – 31 gusht;

- Laguna e Nartës në periudhën 10 shkurt – 31 korrik;

- Laguna e Orikumit në periudhën 15 mars – 31 gusht;

- Laguna e Butrintit në periudhën 1 mars – 31 gusht;

- Liqeni i Shkodrës në periudhat 1 janar – 31 mars dhe 1 korrik – 14 shtator.

1. Ngjala e argjendtë e zënë nga dajlani gjatë periudhës së ndalimit lëshohet në det.

2. Ngjala e verdhë/jeshile e zënë gjatë periudhës së ndalimit lëshohet përsëri në lagunë/liqen”.

3. Masat e parashikuara në “Planin e menaxhimit të ngjalës (*Anguilla Anguilla*)” për vitin 2024 aplikohen deri në vitin 2025.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

